



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 954/2 Prot.

Tiranë, më 10 / 7 / 2018

V E N D I M

Nr. 148 , Datë 10 / 7 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 97, datë 03.07.2018, të paraqitur nga G.Th kundër Kryeplakut të fshatit Selckë në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga G.Th, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se është banor i fshatit Selckë dhe ka kërkuar nga Kryesia e Fshatit një hapësirë me qira për të ndërtuar stallë për lopë, kërkesë e cila i është refuzuar. Më pas është detyruar që në një tokë që kishte me qira me anë të një kredie ta rrethonte dhe të ndërtonte një stallë e cila është kundërshtuar nga Kryesia e Fshatit. Më pas G.Th ka marrë një kullotë në fshatin Pogoni, por dhe atje Kryesia e Fshatit i ka nxjerrë probleme pronësie duke e çuar çështjen në gjykatë. G.Th informon se Kryesia e Fshatit bën çertifikata pronësie fallco që nuk figurojnë në Bashki dhe se Kryeplaku i Fshatit nuk është i rregullt me ligjin duke i përvetësuar të ardhurat dhe jo ti dorëzoi në arkat e pushtetit vendor. Ankuesi informon se në datë 29.08.2016 i kanë helmuar 13 kokë lopë. Ankuesi shpjegon se ditët e fundit pasi situata kishte rënë në qetësi për disa kohë, Kryeplaku i ka kërkuar përsëri lekë nën dorë, por që G.Th shprehet se nuk ka pranuar të paguajë dhe informon se Kryeplaku e ka kërcënuar se do i prishë biznesin si dhe e ofendon me sharje.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që Kryesia e Fshatit ta lërë të lirë për të zhvilluar aktivitetin sipas ligjit.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me*

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkaqet e parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur prova, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me konfliktin dhe problematikën që ka patur për të siguruar kullota me qira nga Kryetari i Fshatit Selckë, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mosdhënia me qira e kullotave është bërë për shkak të “gjendjes ekonomike” apo cilësive të veçanta që ankuesi ka.

Në referim të të dhënave të paraqitura nga subjekti ankues vërehet se pretendimet e tij janë bazuar në denoncimin e veprimeve të paligjshme dhe abuzive, si falsifikim dhe korrupsion nga ana e Kryetarit dhe Kryesisë së Fshatit Selckë dhe jo si pretendime për trajtim të pabarabartë në raport me subjekte të tjerë apo në raport me ligjin.

Referuar për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet korruptive të personave që ushtrojnë funksione publike parashikohen si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe pala ka të drejtë ti denoncojë këto veprime pranë organeve kompetente.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket veprës së “korrupsionit”, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/b dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së G.Th, për shkak se nuk është e pajtueshme me dispozitat e ligjit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI